



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 40.

Prishtinë, më 13.06.2019, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Haxhi Shala, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Shinik, Slobodan Petroviq, Duda Balje dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Igor Simiq, Fadil Beka, Jasmina Zhivkoviq, Sasha Milosavljeviq dhe Zoran Mojsiloviq.

Pjesëmarrës tjerë: Senad Karaahmetoviq OSBE; Nexhmie Hyseni EO; Ilir Hoxha KDI; Zijush Ahmeti KSZ dhe Celal Iliaz, drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Personeli për mbështetjen e komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Xhelal Sveçla**, zëvendëskryetar i komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më, 5.04.2019, 16.04.2019 dhe 24.04.2019;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social, me raport amendamente të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-100 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, me raport amendamente të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor;
5. Të ndryshme.

1. **Miratimi i rendit të ditës.**

Xhelal Sveçla, nënkryetar propozoi që të shtohet si pikë e veçantë e rendit të ditës: formimi i grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, dhe mbikëqyrja e punës së Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. Me këtë propozim, unanimisht, u pajtuan anëtarët e komisionit.

Nënkryetari konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, me propozim të formohen tri grupe punuese: për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokale, dhe mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisë të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më, 5.04.2019, 16.04.2019 dhe 24.04.2019.

Nënkryetari pas diskutimeve konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 5.04.2019, 16.04.2019 dhe 24.04.2019, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social, me raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Nënkryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Danush Ademi sa i përket skemave sociale, ai kishte vërejtje se çdo herë po shkelen të drejtat e komuniteteve jo shumicë. Ne, si përfaqësues të komuniteteve, në vazhdimësi kërkojmë që të ndryshohet me amendament, mandati 5 vjeçar.

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social, me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandon të procedohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-100 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, me raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor.

Nënkryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-100 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 06/L-100 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandon të procedohet për miratim në Kuvend.

5. Formimi i Grupeve punuese, për monitorimin e zbatimit të ligjeve.

Nënkryetari theksoi se komisioni, ka për qëllim që t'i përmbush detyrat që dalin nga Plani i Punës për vitin 2019. Një ndër përgjegjësit e komisioni është që të fillohet me procedurat e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve.

Nënkryetari, dha në propozim që të formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, me këtë përbërje: Veton Berisha, kryesues, Duda Balje, Danush Ademi dhe Albert Kinolli. Këtij grupi punues, iu bashkëngjiten edhe anëtarët Xhelal Sveçla dhe Mufera Serbica- Sinik. I njoftoi anëtarët e komisionit, se ka vënë kontakte me përfaqësues të KDI-së, dhe se ka kërkuar të bëhet një analizë e thukhtë lidhur me këtë ligj, më pas, grupi punues do të shqyrtojë të njëjtin.

Pas konsultimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, mori këtë:

V E N D I M

1. Që Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-040/ 2008 për Vetëqeverisje Lokale;
2. Të formohet Grupi i punës në përbërje: Veton Berisha, kryesues, Xhelal Sveçla, Duda Balje, Danush Ademi, Albert Kinolli dhe Mufera Serbica- Sinik, si bartës të procesit të monitorimit të Ligjit;
3. Që anëtarët e Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjiten Grupit të punës gjatë punës së tij;
4. Që Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësinë mbështetëse të Komisionit, të hartojë Planin e veprimit për mbikëqyrjen e Ligjit, pastaj të përgatisë Raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në komision.

Nënkryetari, propozoi të formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, me këtë përbërje: Duda Balje- kryesuese, Xhelal Sveçla, Slobodan Petroviq dhe Rasim Selmanaj.

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, mori këtë:

V E N D I M

5. Që Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-049/ 2008 për Financat e Pushtetit Lokal;
6. Të formohet Grupi i punës në përbërje: Duda Balje- kryesuese, Xhelal Sveçla, Slobodan Petroviq dhe Rasim Selmanaj, si bartës të procesit të monitorimit të Ligjit;
7. Që anëtarët e Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjiten Grupit të punës gjatë punës së tij;
8. Që Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësinë mbështetëse të Komisionit, të hartojë Planin e veprimit për mbikëqyrjen e Ligjit, pastaj të përgatisë Raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në komision.

Në fund, **nënkryetari**, propozoi të formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësiive të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, me këtë përbërje: Duda Balje - kryesuese, Veton Berisha, Danush Ademi, Albert Kinolli, Slobodan Petroviq. Më pas, grupit punues iu bashkëngjiten edhe anëtarët Xhelal Sveçla dhe Mufera Serbica- Sinik.

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, mori këtë:

V E N D I M

1. Që Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, të mbikëqyrë kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim;
2. Të formohet Grupi i punës në përbërje: Duda Balje - kryesuese, Veton Berisha, Albert Kinolli, Danush Ademi, Slobodan Petroviq, Xhelal Sveçla, dhe Mufera Serbica- Sinik, si bartës të procesit të mbikëqyrjes së ministrisë resorë;
3. Që anëtarët e Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjiten Grupit të punës gjatë punës së tij;
4. Që Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësinë mbështetëse të Komisionit, të hartojë Planin e veprimit për mbikëqyrjen e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, pastaj të përgatisë Raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në komision.

Nënkryetari kërkoi nga kryesuesit e grupeve punuese, që sa më parë të fillojnë me punën e mbikëqyrjes së ligjeve.

Pas diskutimeve, u murr qëndrim që grupet punuese si bartëse të procesit të monitorimit të Ligjit për mbikëqyrjen e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, të takohen me datë 14.06.2019, me qëllim të hartimit të planit të veprimit.

6. Të ndryshme.

Nënkryetari theksoi se komisioni, ka mbetur mbrapa me zhvillimet e realizimit të vizitave në terren. Ne kemi realizuar dy vizita, një në Prizren dhe tjetër në Graçanicë, në muajin nëntor të vitit 2018. Sipas propozimit të tij, javën e ardhshme do të organizohet vizita në komunën e Shtërpces. Qëllimi i vizitës është që të informohemi për sfidat dhe ankesat e qytetarëve, nga se jemi informuar me anë të mediave, se gjatë protestave janë shkelur të drejtat e tyre. Ishte i mendimit që të takohemi me kryetarin e komunës, me institucionet tjera dhe të vihen kontakte me qytetarët.

Duda Balje hapi diskutimin lidhur me ankesat e qytetarëve në Ranillug. Në këtë komunë, në bazë të sistemit paralel, mësimdhënësit marrin paga të dyfishta, një nga Beogradi dhe të dytën nga MASHT-i. Ankesa e tyre është se paga nuk ndahet njëjtë nga MASHT-i. Si shembull mur rastin, në shkollën e mesme, drejtori është i përzgjedhur nga Lista serbe dhe i njëjti bën diskualifikim për ndarjen e pagave për mësimdhënësit dhe në anën tjetër nuk i përmbush obligimet e legjisllacionit në fuqi. Gjithashtu, tha se këtu bëhet fjalë për shkollë të dyfishtë, mësimdhënësit nuk e pranojnë Republikën e Kosovës, shkruajnë në cirilik dhe nuk punojnë me plan program të MASHT-it. Për këto arsye, është mirë të vizitohet kjo komunë, me qëllim të dëgjohen problematikat e qytetarëve.

Anëtarët e komisioni, u pajtuan që stafi mbështetës i komisionit dhe me përkrahje të OSBE-së, të organizojnë vizitën në Ranillug dhe në Shtërpce, me datë 19.06.2019.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Nënkryetari i komisionit,

Xhelal Sveçla